

*Muhamet Bajrami*  
*Muhamet Bajrami*

Dt. 4.04.08

113



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETARE I UJIT**  
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN - BUNE**

Adresa: Qendra Transferimit te Teknologjive Bujqesore.Kati 3-te,Cel.0682081245

Nr. 315 Prot.

Shkoder,dt. 31.03 2008

**INFORMACION**

**“MBI PERDORIMIN E BURIMIT “PERROI I RRUNES”DHE  
“PERROI I MOLLES  
FSHATI RRUNA  
PER PRODHIM TE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA  
SUBJEKTI “OBERALDI ”Sh.p.k.  
H/C NR 2 RRUNA.**

Bazuar ne kerkesen e pa kerkuar te bere nga “ OBERALDI “ Sh.p.k. per perdorim te burimit uJOR PERROI I RRUNES dhe PERROI I MOLLES per prodhim energjie elektrike nen 10 MW, dhe se propozimi i mesiperm, sipas dokumentacionit qe disponon K.B.U. Drin-Bune, nuk ka te beje me projekte, per te cilat ka filluar apo eshte shpallur procedura e perzgjedhjes.

Sipas dokumentacionit te paraqitur nga subjekti i mesiperm, vepra e marrjes se ujit do te ndertohet ne FSHATIN RRUNA ne kuoten 905 m mbi nivelin e detit dhe do te mbledhe ujrat e PERROIT TE RRUNE dhe PERROIT TE MOLLES. Godina e centralit eshte parashikuar te ndertohet ne kuoten 530 m mbi nivelin e detit. Prurjet mesatare jane  $Q = 370$  l/sek, ndersa subjekti do te shfrytezoje nje prurje prej  $Q = 370$  l/sek.

Subjekti gjate periudhes se veres nuk do pengoje vaditjen.

Ky informacion jepet nga K.B.U. Drin-Bune Shkoder, bazuar ne nenet 4, 5, 9 dhe 23 te ligjit nr. 9663 dt. 18.12.2006 “PER KONCESIONET”, dhe ne zbatim te tij te gernes b, pika 1, kreu IV, i V.K.M.-se nr. 27, dt. 19.01.2007, “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies se koncesioneve”, per plotesim dokumentacioni.

**PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES  
DRIN-BUNE**

SEKRETARI

*[Signature]*



KRYETARI

*[Signature]*